

L I G J
Nr.8737, datë 12.2.2001

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1, 148 dhe 149 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është:

- a) përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë;
- b) kushtet që duhet të përmbushin shtetasit që të emërohen prokurorë;
- c) statusi i prokurorit;
- ç) karriera dhe procedimi disiplinor i prokurorit;
- d) marrëdhëniet e Prokurorisë me institucionet e tjera shtetërore, me subjekte të tjera publike ose private dhe me publikun.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së Prokurorisë

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.
2. Prokuroria i ushtron funksionet nëpërmjet prokurorëve.

Neni 3

Struktura e Prokurorisë

Prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si strukturë e centralizuar, ku përfshihen zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshilli i Prokurorisë dhe prokuroritë pranë sistemit gjyqësor.

Neni 4

Ligjshmëria e veprimtarisë

1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.
2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut.
3. Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë jepen me shkrim dhe janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.
4. Prokurorët marrin masa për ushtrimin e ndjekjes penale, zbatimin e udhëzimeve që jepen në përputhje me ligjin, të vendimeve penale dhe të urdhrave të gjykatës, si dhe ndihmojnë në miradministrimin e drejtësisë.

Neni 5
Veprimtaritë parandaluese

Prokuroria organizon dhe/ose bashkëpunon me institucione shtetërore, si dhe me subjekte të tjera publike e private për veprimtari për edukimin e shoqërisë, me synim njohjen e ligjit dhe parandalimin e kriminalitetit.

Neni 6
Marrëdhëniet me publikun

1. Prokuroria vë në dijeni opinionin publik për veprimtarinë që kryen.
2. Prokurorisë nuk i lejohej të japë të dhëna që dëmtojnë procesin e hetimeve, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, që cenojnë të drejtat e të miturve dhe moralin publik.

KREU II
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Neni 7
Emërimi dhe shkarkimi

1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.
2. Prokurori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kuvendit për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve, për paaftësi mendore a fizike, për akte sjelljeje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit.

Neni 8
Detyrat

1. Prokurori i Përgjithshëm është përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, si dhe për parandalimin e detyrave të tjera që me ligj i ngarkohen Prokurorisë.
2. Prokurori i Përgjithshëm ka këto detyra kryesore:
 - a) I propozon Presidentit të Republikës numrin e përgjithshëm të prokurorëve, pasi të ketë marrë mendimin e Ministrit të Drejtësisë.
 - b) I propozon Presidentit të Republikës emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e prokurorëve.
 - c) Cakton drejtuesit e prokurorive dhe zëvendësit e tyre në prokuroritë pranë gjykatave.
 - ç) Miraton strukturën, organikën dhe rregulloret e funksionimit të prokurorive pranë gjykatave dhe të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
 - d) Urdhëron komandimin e prokurorëve.
 - dh) Ushtron funksionet e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Lartë.
 - e) Emëron dhe shkarkon punonjësit e administratës në strukturat e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
 - ë) Përfaqëson Prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët.
 - f) Përcakton pagesat për rastet e shpërblimit të dëshmitarëve ose për sigurimin e provave të rëndësishme për hetimet.
 - g) Jep udhëzime për punën e policisë gjyqësore.
2. Prokurori i Përgjithshëm nxjerr urdhra dhe udhëzime për ushtrimin e detyrave të përcaktuara nga ky ligj ose nga ligje të veçanta.
3. Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me ligjet në fuqi, mund t'i delegojë përgjegjësitë të njëri nga drejtorët e drejtorive, me përjashtim të transferimit, të propozimit për emërim, të ngritjes në detyrë ose të shkarkimit të prokurorëve.
4. Prokurori i Përgjithshëm i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të ndjekjes penale për hartimin e statistikës së njësuar në fushën e drejtësisë.

KREU III
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 9

Struktura dhe funksionet kryesore

1. Struktura e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe detyrat kryesore të hallkave të saj janë:
 - a) Kabineti, i cili jep të dhëna, përgatit dhe bashkërendon marrëdhëniet e Prokurorit të Përgjithshëm me strukturat në vartësi të tij, me institucionet shtetërore dhe me publikun;
 - b) Drejtoritë e hetimit dhe të kontrollit të ndjekjes penale, të cilat bashkërendojnë, kontrollojnë dhe ndihmojnë prokuroritë pranë gjykatave në ushtrimin e funksioneve të tyre.
 - c) Drejtoria e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, e cila inicon, përgatit dhe ndjek realizimin e marrëdhënieve të Prokurorisë me institucionet analoge ose me subjekte të tjera të huaja.
 - ç) Drejtoria e personelit dhe inspektimit, e cila administron dokumentacionin me të dhënat vetjake të kandidatëve, prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë; kontrollon në mënyrë të planifikuar ose për çështje të veçanta ushtrimin e detyrës nga prokurorët; verifikon pasurinë e tyre, si dhe përgatit dokumentacionin për emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e prokurorëve.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, strukturimi, organizimi dhe përcaktimi i hollësishëm i funksioneve të hallkave të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm bëhet nga Prokurori i Përgjithshëm.

KREU IV
KËSHILLI I PROKURORISË

Neni 10

Detyrat

1. Këshilli i Prokurorisë organizon konkursin për emërimin e prokurorëve shqyrton vlerësimin e punës dhe shkeljet disiplinore të kryera nga prokurorët dhe jep mendim për projektaktet e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për praktikën hetimore.
2. Këshilli i Prokurorisë ka funksion këshillimor dhe ia paraqet në çdo rast mendimin e vet Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 11

Përbërja

1. Këshilli i Prokurorisë përbëhet nga shtatë anëtarë. Në Këshillin e Prokurorisë bëjnë pjesë një përfaqësues i Presidentit, një përfaqësues i Ministrit të Drejtësisë dhe pesë prokurorë.
2. Prokurorët, anëtarë të Këshillit të Prokurorisë, duhet të kenë mbi pesë vjet pune si prokurorë. Ata zgjidhen çdo tre vjet nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve. Kandidaturat paraqiten nga një grup me jo më pak se 10 prokurorë dhe votimi bëhet i fshehtë. Mbledhja drejtohet nga Prokurori i Përgjithshëm.
3. Në Këshillin e Prokurorisë nuk mund të zgjidhen ose të jenë anëtarë prokurorët, ndaj të cilëve është dhënë ose jepet masë disiplinore.

Neni 12

Rregullat e funksionimit

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë caktohen nga Prokurori i Përgjithshëm pasi të ketë marrë mendimin e këtij Këshilli.

KREU V
STRUKTURA E PROKURORISË PRANË SISTEMIT GJYQËSOR

Neni 13

Prokurorët pranë Gjykatës së Lartë

1. Pranë Gjykatës së Lartë funksionet e Prokurorisë ushtrohen nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Prokurorët pranë Gjykatës së Lartë ushtrojnë ndjekjen penale, si dhe përfaqësojnë akuzën në gjyq kundër Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Neni 14

Prokurorët pranë gjyqtarëve të apelit

Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate apeli ushtrohen nga prokurorët e apelit. Juridiksioni i tyre shtrihet në të gjithë territorin, ku shtrihet juridiksioni i gjykatës përkatëse.

Neni 15

Prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë

Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate të shkallës së parë ushtrohen nga prokurorët e shkallës së parë. Juridiksioni i tyre shtrihet në të gjithë territorin ku shtrihet juridiksioni i gjykatës përkatëse.

Neni 16

Ushtrimi i detyrës në një shkallë më të ulët

Me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori më i lartë zhvillon hetime dhe përfaqëson akuzën si prokuror i shkallëve më të ulëta.

KREU VI
EMËRIMI I PROKURORIT

Neni 17

Kushte të përgjithshme

Emërohet prokuror në njërën nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, personi që plotëson këto kushte:

- është shtetas shqiptar;
- ka zotësi të plotë për të vepruar;
- ka arsim të lartë juridik;
- ç) ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- d) nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- dh) nuk është larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike brenda një afati prej tre vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës; kur shkelja disiplinore është kryer gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar, prokuror, oficer i policisë, noter ose avokat, afati është pesë vjet;
- është jo më pak se 25 vjeç.

Neni 18

Kushte të veçanta

Mund të emërohet prokuror edhe personi që nuk ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, nëse përmbush kriteret e tjera të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji dhe njërin prej kushteve të mëposhtme:

ka punuar gjyqtar ose prokuror;
b) ka punuar, jo më pak se tre vjet, pedagog në Shkollën e Magjistraturës, në Fakultetin Juridik, këshilltar ligjor, drejtues ose specialist në strukturat juridiko-profesionale në Kuvend, pranë Presidentit, në Këshillin e Ministrave, në Gjykatën e Lartë, në Ministrinë e Drejtësisë, pranë Zyrës së Avokatit të Popullit ose deputet me arsim të lartë juridik, si dhe oficer në policinë gjyqësore.

Neni 19

Kufizime të emërimit

1. Prokurorët nuk mund të shërbejnë pranë të njëjtës gjykate ku ushtrojnë funksionet e prokurorit ose të gjyqtarit pesona me të cilët ka lidhje gjinie ose martesore, cilado qoftë shkalla e lidhjes në vijë të drejtë dhe deri në shkallën e dytë në vijë të tërthortë.
2. Prokurorët nuk mund të shërbejnë në rrethin ku kanë punuar si avokatë.

Neni 20

Konkurrimi

1. Prokurori i Përgjithshëm, pasi ka marrë mendimin e Këshillit të Prokurorisë shpall publikisht vendet vakant për prokurorë së paku një muaj para datës së caktuar për zhvillimin e konkurrit. Shpallja bëhet në të paktën dy gazeta me shpërndarje kombëtare dhe tirazh të mjaftueshëm, si dhe me anë të Radios dhe Televizionit Publik.

Depozitimi i kërkesave të shoqëruara me dokumentet e kërkuara për pranimin në konkurrim duhet të bëhet nga konkurruesit jo më vonë se dy javë nga data e fundit e shpalljes publike të vendit vakant.

2. Për plotësimin e vendeve vakante merret në shqyrtim, diskutohet dhe vendoset mbi kandidaturat e paraqitura nga prokurorët. Në mungesë ose pas shqyrtimit të këtyre kandidatave, shqyrtohen, diskutohen dhe vendoset për kandidatët e tjerë që përmbushin kriteret ligjore për t'u emëruar prokurorë.

3. Këshilli i Prokurorisë bën vlerësimin e kandidatave dhe mendimin e tij ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm, i cili duhet të shprehet brenda 15 ditësh.

4. Rregullat e detajuara të paraqitjes, përzgjedhjes, verifikimit dhe testimit të kandidatave caktohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 21

Emërimi

Kandidatët për prokurorë emërohen në detyrë nga Presidenti i Republikës me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi bazën e rezultateve të konkurrit.

Neni 22

Betimi

1. Para fillimit të detyrës, prokurorët bëjnë betimin si vijon:
“Betohe më solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të ruaj të pastër figurën e prokurorit. Betohe më!”

2. Betimi i prokurorëve të sapoemëruar bëhet në mënyrë ceremoniale përpara të gjithë prokurorëve të strukturës ku janë caktuar për kryerjen e detyrës.

3. Prokurori i Përgjithshëm cakton rregullat për procedurën e betimit.

Neni 23

Prokurorët në stazh

1. Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës emëron prokurorë në stazh personat që kanë mbaruar vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës, për të kryer stazhin profesional, të parashikuar në ligjin nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në

Republikën e Shqipërisë” në prokuroritë pranë gjykatave që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi.

2. Kriteret e përcaktuara në shkronjat “ç” dhe “e” të nenit 17 të këtij ligji nuk përbëjnë pengesë për emërimin e personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Pas përfundimit të stazhit profesional, Presidenti i Republikës dekreton caktimin e tyre në prokuroritë sipas nevojave që kanë këto të fundit.

Neni 24

Ngritja në detyrë dhe transferimi

1. Ngritja në një detyrë më të lartë ose transferimi mund të bëhet vetëm për nevoja dhe në interes të punës nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prokurorit.

2. Bëjnë përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni rastet e parashikuara nga nenet 25 dhe 33 të këtij ligji.

Neni 25

Komandimi

Prokurori i Përgjithshëm mund të komandojë një ose më shumë prokurorë nga prokuroritë ku punojnë në prokurori të tjera të të njëjtin nivel edhe pa pëlqimin e tyre:

a) jo më shumë se për dy periudha në vit deri në tre muaj secila, në rastet kur një prokurori nuk funksionon normalisht për shkak të pamjaftueshmërisë së prokurorëve ose të mbingarkesës;

b) jo më shumë se koha e nevojshme për përfundimin e procesit të një çështjeje të veçantë, kur paraqitet nevoja e hetimit ose e gjykimit të saj.

Neni 26

Pezullimi

1. Prokurori mund të pezullohet në ushtrimin e detyrës me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm në këto raste:

a) kur ndaj tij vendoset nisja e procedimit penal deri në përfundimin e procedimit;

b) kur zbulohet një shkelje e rëndë disiplinore, derisa të plotësohet procedura e kërkuar për përgjegjësinë disiplinore, por jo më tepër se 30 ditë;

c) kur Prokurori i Përgjithshëm i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin e prokurorit nga detyra.

2. Në rastin e pezullimit sipas pikës 1 të këtij neni, përkatësisht kur prokurori nuk gjendet fajtor nga gjykata ose nuk ka kryer shkelje disiplinore, ose ka kaluar afati prej 30 ditësh, i parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë të kthehet në detyrën e mëparshme.

3. Pezullimi i parashikuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni mbaron pas shqyrtimit nga Presidenti i Republikës të propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 27

Largimi dhe shkarkimi nga detyra

Prokurori largohet nga detyra në këto raste:

kur jep dorëheqjen;

kur mbush moshën 65 vjeç;

c) kur i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Prokurori i Përgjithshëm, pasi ka marrë pëlqimin e vetë prokurorit, mund të vendosë mbajtjen në detyrë të prokurorit që ka mbushur moshën për pension, të parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni.

3. Prokurori shkarkohet nga detyra në këto raste:

a) kur dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) kur merret masë disiplinore sipas shkronjës “d” të nenit 32 të këtij ligji;

c) kur është vlerësuar i paaftë në përputhje me pikat 3 e 4 të nenit 42 të këtij ligji.

KREU VII PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 28

Fillimi i procedimit

1. Fillimi i procedimit disiplinor bëhet nga Prokurori i Përgjithshëm, kryesisht ose me rekomandimin e Këshillit të Prokurorisë.

2. Procedimi mbështetet në të dhënat e nxjerra nga inspektimi, për të cilin prokurori që procedohet është njoftuar paraprakisht. Procedimi fillon kur nga çasti i vënies re të shkeljes nuk kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj dhe nga çasti i kryerjes së shkeljes nuk kanë kaluar më shumë se tre vjet.

Neni 29

Njohja me dokumentacionin e procedimit

1. Prokurorit të proceduar i jepet paraprakisht dokumentacioni i procedimit të nisur në ngarkim të tij, si dhe në afat jo më pak se 10 ditë për të përgatitur mbrojtjen.

2. Dita e shqyrtimit të materialeve i bëhet e njohur paraprakisht prokurorit të proceduar.

Neni 30

E drejta për t'u dëgjuar

1. Prokurori, në ngarkim të të cilit është nisur procedimi disiplinor, ka të drejtë të mbrohet, duke u paraqitur vetë para Këshillit të Prokurorisë, i cili është i detyruar ta dëgjojë dhe të verifikojë pretendimet e ngritura.

2. Mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme nuk e pengon Këshillin e Prokurorisë ta shqyrtojë çështjen dhe të nxjerrë përfundimet përkatëse.

Neni 31

Shqyrtimi i mendimeve të Këshillit të Prokurorisë

Për mendimet e dhëna nga Këshilli Prokurorisë për shkeljet disiplinore, Prokurori i Përgjithshëm shprehet brenda 15 ditëve nga paraqitja, duke arsyetuar qëndrimin e vet.

Neni 32

Shkeljet disiplinore

Quhen shkelje të disiplinës në punë:

mospranimi i bërjes së betimit ose shkelja e tij;

b) zvarritjet e rënda ose sistematike të procedimeve ose të detyrave të tjera të ngarkuara ose mospërmbushja e detyrave;

c) nxjerrja e sekretit të hetimit ose e të dhënave të tjera me karakter konfidencial;

ç) mungesa për më shumë se pesë ditë pa arsye në punë;

d) kryerja e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit;

dh) kryerja e veprimeve që, sipas ligjit, janë të papajtueshme me funksionet e prokurorit.

Neni 33

Masa disiplinore

1. Për shkelje të disiplinës ndaj prokurorëve merren këto masa:
vërejtje;

b) vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra;

c) pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër, më të ulët, brenda organit, për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit;

ç) shkarkim nga detyra.

2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni jepen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm dhe shënohen në dosjen vetjake të prokurorit.

3. Shkarkimi nga detyra bëhet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Propozimi për shkarkim shoqërohet me kundërshtimet e prokurorit që procedohet disiplinarisht.

4. Masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni fshihen nga dosja kur kanë kaluar:

a) tre muaj nga data që është dhënë masa sipas shkronjës “a”;

b) një vit nga data që është dhënë masa sipas shkronjës “b”;

c) një vit nga data që ka përfunduar masa e dhënë sipas shkronjës “c”.

Neni 34

Ankimi

1. Kundër dhënies së masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 33 mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit në Tiranë.

2. Dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra është i paankimueshëm.

KREU VIII

STATUSI DHE KARRIERA E PROKURORIT

Neni 35

Mbrojtja e veçantë

Prokurori ka të drejtë të ketë mbrojtje të veçantë vetjake, si dhe për familjen dhe pronën, kur një gjë e tillë paraqitet e nevojshme në rrethanat e një rreziku serioz të lidhur me ushtrimin e detyrës.

Neni 36

Mbrojtja nga procesi penal

1. Prokurori nuk mund të ndalohet, kontrollohet ose arrestohet pa pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm, përveç rasteve kur kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Në këto raste organi përgjegjës njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm.

2. Në qoftë se Prokurori i Përgjithshëm brenda 24 orëve nuk jep pëlqimin për dërgimin në gjykatë të prokurorit, organi përgjegjës është i detyruar ta lirojë prokurorin e ndaluar.

Neni 37

Trajtimi në rastet e cenimit të lirisë

Në rastet kur prokurori ndalohet dhe ndaj tij është dhënë masa e sigurimit “arrest në burg” ose është dënuar me burgim, ai qëndron në mjedise pa persona të tjerë, përveç rasteve kur ai vetë heq dorë me shkrim nga kjo e drejtë.

Neni 38

Pjesëmarrja në shoqata

1. Prokurori është i lirë të marrë pjesë në shoqata ose organizata me veprimtari jofitimprurëse ose që kanë për qëllim respektimin e etikës ose ngritjen profesionale.

Prokurorit i ndalohet të bëjë grevë.

Neni 39

Papajtueshmëritë

1. Prokurorit i ndalohet të bëjë pjesë në parti politike ose të marrë pjesë në veprimtari me

karakter politik.

2. Funksioni i prokurorit është i papajtueshëm me kandidimin dhe me çdo mandat zgjedhor, detyrë ose veprimtari publike, me përjashtim të veprimtarive edukative e të mësimdhënies.

3. Prokurorit i ndalohet dypunësimi, me përjashtim të veprimtarive të lejuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Prokurorit i ndalohet të marrë pjesë në organet drejtuese të shoqërive tregtare.

Neni 40

Ruajtja e të dhënave të procesit

1. Prokurorëve u ndalohet të bëjnë publike ose t'u japin personave të tretë të dhëna që mund të dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

2. Prokurorëve u ndalohet të bëjnë deklarata ose të japin mendime për veprimtarinë e organeve të tjera.

Neni 41

Ngritja profesionale

1. Prokurorët kanë të drejtë dhe detyrim të marrin pjesë në trajnime periodike për ngritjen e nivelit të tyre profesional.

2. Prokurorët përfitojnë falas Fletoren Zyrtare dhe literaturë tjetër juridike.

Neni 42

Vlerësimi i punës

1. Për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve, Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit kryen detyrimisht inspektimin e planifikuar jo më pak se një herë në dy vjet.

2. Vlerësimi bëhet në bazë të vëllimit të punës, të cilësisë dhe të shpejtësisë së kryerjes së saj, të masave disiplinore të dhëna, si dhe të botimit të punimeve juridike.

3. Këshilli i Prokurorisë shqyrton vlerësimin e punës dhe mendimin e vet ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm i cili duhet të shprehet brenda 15 ditësh.

Shkallët e vlerësimit janë :

Shumë mirë

Mirë

Mjaftueshëm

I paaftë

5. Sistemi i vlerësimit të punës së prokurorëve caktohet nga Prokurori i Përgjithshëm, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit të Prokurorisë.

6. Vlerësimi “i paaftë” përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

Neni 43

Ngritja në detyrë

1. Pas ushtrimit të detyrës për një afat jo më të shkurtër se pesë vjet në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, prokurori mund të emërohet në njërën nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit.

2. Pas ushtrimit të detyrës për një afat jo më të shkurtër se 10 vjet në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, ose jo më të shkurtër se pesë vjet në prokuroritë pranë gjykatave të apelit, prokurori mund të emërohet në strukturën e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Ngritja në detyrë e prokurorit bëhet kur, përveç plotësimit të përvojës së parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, puna e tij gjatë pesë vjetëve të fundit është vlerësuar jo më ulët se “mirë”.

4. Kur për çdo vend vakant konkurrojnë dy ose më shumë kandidatë, Prokurori i Përgjithshëm propozon për emërim kandidatin që ka më tepër merita dhe përvojë.

Neni 44
Punësimi si nëpunës civil

1. Prokurori mund të punojë në nivele drejtuese dhe ekzekutuese të kabinetit të Ministrit dhe të strukturave juridiko - profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e punësimit të tyre në këto struktura njihet si periudhë vjetërsie në punë si prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale.

2. Prokurorët që punojnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesën e tyre riemërohen pa konkurs prokurorë.

Neni 45
Dokumenti i identifikimit

Prokurori pajiset me dokument identifikimi. Forma dhe përmbajtja e dokumentit përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 46
Pajisja me armë

Prokurori ka të drejtë të mbajë armë vetjake, me të cilën pajiset sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 47
Strehimi

1. Prokurori ka të drejtë të përfitojë banesë me kredi me kushte lehtësuese kur nuk ka banesë ose sipërfaqe të banueshme banimi në rrethin ku punon.

2. Në rast se prokurori ka banesë në një rreth tjetër nga ai ku ushtron detyrën, ai përfiton sipas pikës 1 të këtij neni, por shuma e kredisë do të jetë sa diferenca ndërmjet vlerës së kredisë për banesën e re me vlerën e banesës që ka në pronësi.

3. Fondet për strehim parashikohen në buxhetin vjetor të Prokurorisë.

Neni 48
Shpenzimet e transferimit

1. Prokurori gëzon të drejtën e paradhënies ose të rimbursimit të plotë të shpenzimeve të transferimit të tij dhe të familjes, si dhe të transportit të orendive shtepiake, kur ai ngrihet në detyrë ose transferohet në një rreth tjetër për shkaqe që nuk lidhen me masa disiplinore.

2. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë kur transferohet me kërkesën e vet.

Neni 49
Koha e punës

1. Koha javore e punës dhe orari, si rregull, janë të njëjta me ato të punonjësve të administratës publike.

2. Në rast nevojë, me urdhër të eprorit të drejtpërdrejtë, prokurori është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit, në ditët e pushimit javor, të festave ose kur është duke kryer lejen vjetore.

3. Titullarët e çdo strukture të Prokurorisë organizojnë shërbimin e radhës për ditët e javës, të fundit të javës dhe të festave. Lista e shërbimit caktohet çdo muaj. Për ditët e parashikuara në listën e shërbimit të radhës, prokurorët detyrohen të lënë adresën e saktë të vendndodhjes së tyre.

Neni 50
Leja vjetore

1. Prokurori gëzon të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 30 ditësh. Leja vjetore, si rregull, bëhet në muajt korrik dhe gusht .

2. Në rastet kur prokurori ngarkohet me kryerjen e detyrave të ngutshme në periudhën korrik - gusht, si dhe kur ndërpret lejen për nevoja pune, përveç ditëve të pushimit të mbetura, përfiton deri në pesë ditë pushimi shtesë.

3. Prokurorët kur largohen me leje vjetore detyrohen të lenë adresën e saktë të vendit ku do të kryejnë pushimet dhe ditët e qendrimit atje.

Neni 51

Leja për raste të veçanta

1. Për nevoja të veçanta, vetjake ose familjare, prokurori ka të drejtë të përfitojë leje të papaguar deri 20 ditë në muaj, por jo më tepër se 30 ditë në vit.

2. Në raste martesash ose vdekjesh brenda familjes, kur është konsumuar koha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, prokurori ka të drejtë të përfitojë deri në 10 ditë leje.

Neni 52

Paga dhe shpërbimet

1. Paga e Prokurorit të Përgjithshëm është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

2. Paga e prokurorit rregullohet me ligj. Paga e prokurorit është e barabartë me pagën e gjyqtarit të gjykatës pranë të cilës funksionon prokuroria ku ai është emëruar.

3. Në ditët e shërbimit pagesa është 20 për qind më e lartë se ditët e zakonshme të punës.

4. Prokurori mund të përfitojë shpërblime për merita profesionale në masën e caktuar me propozimin e eprorit dhe me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

5. Prokurori, me propozim të eprorit dhe me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm, mund të përfitojë deri në 10 për qind shtesë page për vështirësi pune.

KREU IX

MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA

Neni 53

Marrëdhëniet me Kuvendin

1. Prokurori i Përgjithshëm informon Kuvendin ose komisionet parlamentare të paktën një herë në gjashtë muaj ose sa herë që kërkohet prej tyre. Njoftimi përmban të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe drejtimit dhe përparësitë në luftën ndaj kriminalitetit.

2. Nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara me vendim të Kuvendit.

3. Kuvendi mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm sugjerime për rregullimin ligjor të çështjeve të ndryshme.

4. Prokurori i Përgjithshëm bashkëpunon me komisionet e hetimeve parlamentare sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 54

Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave

1. Çdo vit, jo më vonë se data 31 mars, Ministri i Drejtësisë, në emër të Këshillit të Ministrave, i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet që duhet të mbahen parasysh për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit.

2. Prokurori i Përgjithshëm ua bën të njohura rekomandimet e Këshillit të Ministrave

drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve në një mbledhje të përbashkët, ku merr pjesë edhe Ministri i Drejtësisë, jo më vonë se muaji prill. Rekomandimet e analizuara në mbledhje bëhen publike.

3. Në marrëdhëniet e Prokurorit të Përgjithshëm me Këshillin e Ministrave ndalohen rekomandimet për të proceduar ose jo për çështje konkrete.

Neni 55

Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Drejtësisë

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm që, në bazë të të dhënave të dala nga mbledhjet e tij dhe që implikojnë prokurorët, të nisë procedimin disiplinor.

2. Prokurori i Përgjithshëm mund t'i drejtohet Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të kërkuar çdo material përgjithsues për gjendjen e procedimeve penale në gjykata, problemet e ndjekjes penale ose për çështjet organizative e strukturore që lidhen me prokurorinë.

Neni 56

Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë kontrollon në mënyrë të planifikuar ose në bazë të informacioneve të dhëna nga organe, institucione ose persona të interesuar, ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve.

2. Objekti i kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë në organin e prokurorisë është:

a) ndjekja e ecurisë së çështjeve që përmbahen në rekomandimet vjetore të dhëna nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit;

b) respektimi i afateve të hetimit;

c) respektimi i afateve të paraburgimit;

ç) respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të subjekteve të procedimit penal dhe, në veçanti, të të ndaluarve dhe të arrestuarve;

d) rregullshmëria dhe vijueshmëria e kryerjes të veprimeve hetimore;

dh) respektimi i detyrimit ligjor të prokurorit për fillimin e ndjekjes penale;

e) ecuria e politikës penale dhe, në veçanti, e politikës së dënimeve që ndiqet nga prokurorët;

ë) rregullshmëria e mbajtjes dhe administrimit të statistikave dhe regjistrimit të veprave penale;

f) respektimi i parimeve të drejtësisë, barazisë dhe ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorit në marrëdhëniet e tij me subjektet e tjera të procedimit penal.

3. Kontrolli në çdo rast duhet të jetë i paralajmëruar dhe për çështje për të cilat kanë përfunduar hetimet paraprake.

4. Për rezultatin e kontrollit vihet në dijeni Presidenti i Republikës, Prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori, veprimtaria e të cilit ka qenë objekt kontrolli.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 57

Buxheti

Prokuroria ka buxhet të pavarur që hartohet, administrohet e zbatohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 58

Punonjësit e administratës

Punonjësit e administratës emërohen dhe shkarkohen nga drejtuesi i Prokurorisë ose nga Prokurori i Përgjithshëm për punonjësit e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Marrëdhëniet e tyre të punës rregullohen me Kodin e Punës.

Neni 59

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Çështjet e parashikuara në nenet 13, 14, 15, 40, 41, 49, 50 e 51 të këtij ligji, rregullohen me akte nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Çështjet e parashikuara në nenet 5 dhe 37 të këtij ligji rregullohen me akte të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Drejtësisë.
3. Çështjet e parashikuara në nenet 35, 36 dhe 46 të këtij ligji rregullohen me akte të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Rendit Publik.

Neni 60

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2908, datë 27.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani